




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
**Komiteti për Komunitete**  
Nr.01-060/01-2543/23 datë: 24.01.2023



Npi – 01/42 datë: 25.01.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 25.01.2023, nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE**

E mbajtur më: 25.01.2023 (e mërkurë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë , Zëvendës Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Arton Demiri dhe znj.Shkurte Mustafa. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: z.Ibrahim Demiri, nga OSBE, z.Muharrem Haziri, nga UNMIK-u znj.Arianita Beqa – Rraci, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se me 23.12.2022
2. Draft – Plani i Punës së KPK-së për vitin 2023
3. Propozim – vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të KPK-së për vitin 2023
4. Diskutim për manifestimin e 15 shkurtit – Ditës Nacionale të Komunitetit Ashkali
5. Raporti i punës së KPK-së për vitin 2022, nga Kryesuesi i KPK-së
6. Të ndryshme.
7. **Draft- Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023, (pas diskutimit publik)**

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z.Besnik Seferi;** Përshëndetje, për të gjithë, sa i përket pikave të rendit të ditës ndoshta është dashtë të jete edhe “Raporti Vjetor Financiar për vitin 2022” dhe pika “Rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023”. Propozoj që të futen si pika shtesë të rendit të ditës.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Me Planin e Punës e kemi pasur në muajin dhjetor dhe është larguar.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Unë jam kundër rritjes së tarifës së kërkuar nga K.R.M “Pastërtia” Njësia në Shtime, por nuk jam kundër për me u diskutuar.

**z.Besnik Seferi;** Mendoj se është mirë me u diskutuar kjo rregullore, sepse është në interes të përgjithshëm.

**znj.Shkurte Mustafa;** Ne e kemi marr materialin për këto pika të rendit të ditës që janë në ftesë, për këto të tjerat që po propozohen këtu nuk e kemi marr material.

**\*Komiteti për Komunitete, me 2 vota “Për”, 4 vota “Kundër” dhe 0 vota “Abstenim” nuk e miratoi propozimin e Besnik Seferit që si pikë shtesë e rendit të ditës të futet edhe “Raporti Vjetor Financiar për vitin 2022”.**

**\*Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi propozimin e Besnik Seferi që si pikë shtesë me numër 7 të futet edhe “Draft- Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023, (pas diskutimit publik)”.**

**\*Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi renin e ditës me pikën shtesë 7 “Draft- Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023, (pas diskutimit publik)”**

#### Pika 1

##### Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-së me 23.12.2022

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Besnik Seferi;** Po dua mi komplimentuar procesmbajtësit me qenë se takimet tona më parë kanë qenë pak të mangëta, karshi diskutimeve që i kemi bërë, mirëpo tani procesverbalet janë tu ardhur deri në atë mënyrë sa që me të vërtet ta kenë një shkurtim të fjalimeve tona, por kanë një kuptim të plotë të asaj çka kemi dashur me thënë. Prandaj jam pro procesverbalit që me vazhduar tutje, shpresoj që një procesverbal i tillë të na vije edhe herëve tjera.

**\*Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KPK-së e mbajtur më 23.12.2022.**

#### Pika 2

##### Draft – Planin e Punës së KPK-së për vitin 2023

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** E falënderojmë ZKKK-në dhe Muahmet Mehmetin për punën shumë të mirë që e kanë bërë. Në vazhdim lexoi Draft - Planin e Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.

**z.Besnik Seferi;** Unë e kam pritë pak më ndryshe një planë, kemi thënë që të ketë përputhshmëri me planin e punës së Kuvendit. Për muajin Janar p.sh nuk ka fare renditje të pikave. Ky format nuk e definon mirë punën tonë. Nëse e aprovojmë një format të tillë ka me qenë një gabim i yni.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** E kam lexuar dhe analizuar Draft – Planin e Kuvendit, nëse e krahasojmë me Planin e Punës së Komitetit ka përputhje shumë të madhe. Nuk i kemi specifikuar pikat por i kemi caktuar objektivat. Edhe muajt përputhen me Draft – Planin e Punës së Kuvendit.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Edhe unë desha me thënë se kam qenë në grupin e punës për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit, dhe nuk po shohë mospërputhje të Planit të Komitetit për Komunitete me Planin e Punës Së Kuvendit. Unë propozojë ta miratojmë.

**z.Besnik Seferi;** Ky plan sa e kam parë është ma modern se planet tjera.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Në po i caktojme terminet e mbledhjeve të Komitetit, por nevojitet që me ju përmbajte këtyre termineve. KPK është Komitet obligativ dhe ka marrë më së shumti rekomandime.

**znj.Shkurte Mustafa;** Unë jam pro për këtë planë të punës. Nëse kemi diçka me shtuar ne mundemi.

**z.Muharrem Haziri, OSBE;** Përshëndetje, duhet me thënë se agjenda e KPK-së duhet me u dakordua me atë të Kuvendit. Por ne duhet me pyet se a i keni paraparë diskutimet për buxhet i cili është i nevojshëm për KPK-në. Propozojë që nëse nuk është në plan me u fut edhe çështja e buxhetit për aktivitetet që duhet bërë e që ju i keni paraparë.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Në muajin Gusht ne i kemi paraparë dhe i kemi dhënë rekomandimet tona të KPK-së.

**\*Komiteti për Komunitete unanimitisht miratoi planin e punës të KPK-së për vitin 2023.**

### Pika 3

#### Propozim – vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të KPK-së për vitin 2023

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Idajet Rexhepit.

**z.Idajet Rexhepi, zyrtar i Kuvendit;** Dha sqarime për harmonizimin e orarit të Komitetit me orarin e mbledhjeve të Kuvendit, dhe komiteteve tjera.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Unë propozojë që ta kemi si orar paradite.

**z.Arton Demiri;** Jam që orari i mbledhjeve të jetë në ora 14:00h.

**z.Muhamet Mehmeti;** Edhe unë jam që orari të jetë në ora 14:00h.

**z.Besnik Seferi;** Unë pata qejf me ditë edhe për ju si OSBE e UNMIK, a jeni, që të jetë orari i mbledhjeve pasdite.

**z.Muharrem Haziri, OSBE;** Ne punojmë deri në ora 17:00h. Faleminderit për respektin por ne do ti përshtatemi orarit që ju e caktoni. E shikova orarin që janë 3, 4 ditë para Kuvendit.

**znj.Shkurte Mustafa;** Për mua kishe me qenë më mirë paradite, por edhe pas dite bën.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Mua më konvenon me qenë në ora 14:00h, për shkak të angazhimeve që kam në organizatë.

**\*Komiteti për Komunitete unanimisht miratoi Vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve për vitin 2023.**

### Pika 4

#### Diskutim për manifestimin e 15 shkurtit – Ditës Nacionale të Komunitetit Ashkali

**Kryesuesi, z.Bajram Ilazi;** Fatkeqësisht nuk e kemi zyrtarin nga ZKKK, z.Ibrahim Demiri për me na dhënë sqarime.

**z.Muhamet Mehmeti;** Unë kam qenë pjesë e grupit të organizimit ne më parë i kemi marrë mjetet nga DKRS-ja edhe pse ka pas problem, sepse është dashur vetë me i plotësuar e pastaj edhe janë vonuar.

**z.Besnik Seferi;** Jemi njëri prej komiteteve që kemi bërë shumë zurma për buxhetin e KPK-së, jemi në prag të asaj sepse jemi në fund të Janarit. Unë kam diskutuar në Kuvend për këtë por më është thënë se do të ketë vijë buxhetore. Krejt viti do të jetë shumë më mirë, sepse buxheti është ngritur pse jo të shkojmë e ta diskutojmë me drejtoreshën e DKRS-së.

**z.Muharrem Haziri, OSBE;** I njëjti problem është edhe në Komunat tjera problemi juaj është me bërë edhe me qitë në letër. Kështu ju mundeni me adresuar këtë çështje më mirë.

**z.Muhamet Mehmeti;** Unë qe 8 vjet jam anëtarë i Komisionit. Ne e kemi programin por problemi është te buxheti.

**z.Besnik Seferi;** Pajtohem, duhet me pas një plan, por jo me qenë i pa arritshëm por me qenë real. Unë pajtohem që nesër të fillojmë. Propozimet duhet të jenë të përputhshme me financat.

### Pika 5

#### Raporti i punës së KPK-së për vitin 2022, nga Kryesuesi i KPK-së

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Lexoi Raportin e Punës së Komitetit për vitin 2022, të cilin e ka përgatitur sekretaria e Kuvendit. Në vazhdim hapi diskutimin.

**z.Besnik Seferi;** Kisha prit një diskutim nga monitoruesit që e bëjnë për KPK-në unë jam pro, sepse ka kaluar ky raport.

**z.Muharrem Haziri, OSBE;** Ne e kemi përcjell punën dhe e kemi një plan që shumë shpejt do të fillojmë edhe pse ju jeni të ri. Edhe pse ne qe 20 vjet po punojmë, por kemi nevojë ti përsëritim gjërat nëse jeni të interesuar për praktika të mira, ndoshta është mirë me bërë ndonjë vizitë në ndonjë Komunë tjetër që kanë provojë më të mirë. Ne do të ju njoftojmë për një takim që do ta mbajmë së shpejti.

**znj.Arianita Beqaj-Rraci, UNMIK;** Përshëndetje, ne jemi këtu më shumë për monitorim, ndërsa OSBE-ja e ka pak më ndryshe praktiken e punës. Disa Komuna e bëjnë ndonjë praktikë më të mirë e disa më pak, dhe ne i kombinojmë praktikat që janë dalë me një punë më të suksesshme

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Ju Faleminderit edhe juve edhe Idajetin që na kanë ndihmuar me punën e tij. Diçka çka duhet me përmend në procesverbal është mungesa e Drejtorëve në mbledhjet e Komiteteve.

**\*Komiteti për Komunitete, unanimsht aprovoi, Raportin e Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2022.**

### **Pika 6**

#### Të ndryshme

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Arianita Beqaj-Rraci, UNMIK;** Unë vetëm një lajmërim dua me bërë që ka të bëjë me një thirrje të UNMIK-ut për projektet që financohen nga UNMIK-u. Projektet kanë të bëjnë me ndërtimin e një besimi mes Komuniteteve dhe mund të aplikojnë Organizata të ndryshme, institucione lokale gjithashtu edhe qendrore. Kushtet dhe kriteret janë brenda web-faqes së UNMIK-ut, por janë krejt në gjuhën angleze, edhe natyrisht formularët janë në gjuhën angleze, krejt duhet me u paraqit në gjuhën angleze. Buxheti për këtë është 25 mijë dollar për një projekt maksimalja që mundet me u financuar, por një prej pikave kryesore është kjo ndërtimi i mirëbesimit në mes Komuniteteve, prandaj ta keni parasysh ka filluar prej të hënës dhe rrinë 4 javë i hapur konkursi deri me 20 Shkurt që projektet duhet me u dorëzuar.

### **Pika 7**

#### Draft- Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, (pas diskutimit publik)

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Besnik Seferi;** E kemi një rregullore që duhet ta diskutojmë dhe duhet ta japim një rekomandim. Mirëpo kemi edhe një kërkesë nga K.R.M “Pastërtia” njësia në Shtime për ngritjen e çmimeve të shërbimeve, për të cilën duhet të diskutojmë.

**Kryesuesi, z.Bajram Ilazi;** Në diskutimet tjera publike që organizohen duhet të bëhen edhe brenda vendbanimeve, e jo vetëm në Qendër. E kemi një gjendje të rëndë socio-ekonomike për familjarët e Komunitetit Ashkali e Rom prandaj për këto familje mos të bëhet kjo ngritje. Tarifa prej 1 euro është një barrë. Dhe duhet që DSHMS-ë të bëjë një listë për këto familje.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Unë jam kundër kësaj ngritje të tarifave nga K.R.M “Pastërtia” Njësia në Shtime, edhe më herët kam thënë.

**znj.Shkurte Mustafa;** Edhe unë jam kundër kësaj ngritje së kësaj tarife, sepse disa familje e vuajnë këtë pastaj.

**z.Muhamet Mehmeti;** Edhe unë jam kundër ngritjes së tarifës, sepse konsiderojë se është ngarkesë.

**\*Komiteti për Komunitete, unanimsht vendosi që t’i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratojë Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, me vërejtjen që nuk e aprovon kërkesën e KRM “Pastërtia” Njësia në Shtime për ngritjen e çmimeve të shërbimeve.**

Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 16.12h.

Procesmbajtës  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit  
Bajram Ilazi

